



Fronine Arzdeh  
Bydab



S. Gremi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1498/2 Prot.

Vlorë më, 21 08 .2023

**VENDIM**  
Nr. 44, datë 16.08.2023

**PËR**  
**PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUARA PËR STAFIN**  
**AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar relacionit të Zv/Rektorit Akademik ardhur e shkresën nr.1455/10 prot, datë 08.08.2023, si dhe shkresës së Administratorit nr.1455/16 prot, datë 14.08.2023 "Përcjellje e efektit financiar, për pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16.08.2023'

**VENDOSI:**

1. Ti propozojë Bordit të Administrimit pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2022-2023 për orët suplementare të paraqitura nga Njësitë Bazë dhe Njësitë kryesore përveç rasteve të cituara më poshtë:
  - a) Orëve suplementare mbi 200 orë në auditor për të cilat nuk ka dokumentacion argumentues nga përgjegjësit e njësisve bazë (konform udhëzimi nr 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë).
  - b) Orët e temave të diplomave pa dokumentacionin të plotë ( te cilat do te merren ne shqyrtim pasi të jetë dërguar në rektorat dokumentacioni sipas procedurës së miratuar në vendimin e Senatit Akademik Nr.65, datë 14.11.2016 "Për administrimin e dokumentacionit akademik dhe administrativ të Fakulteteve dhe Departamenteve")
2. Ngarkohet Drejtoria e Edukimit e Ciklit të parë dhe të dytë si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për të llogaritur orët si dhe efektin financiar të mbingarkesës. ✓
3. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
Prof.Dr. Roland Zisi

